

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS KORÇË

Raporti përfundimtar i auditimit të ushtruar në Degën e Doganës Korçë “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Degës së Doganës Korçë me kriteret dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi” për periudhën 01.01.2013 - 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 160, datë 16.12.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 741/15, datë 16.12.2015, i është dërguar Degës së Doganës Korçë dhe me shkresën nr. 741/16, datë 16.12.2015 Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet” për marrjen e masave.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

A. 1.1 Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sektori i financës në Degën e Doganës Korçë në lidhje me të ardhurat dytësore, nuk rezultojnë të arkëtuara nga zëri i të ardhurave “Parkingut doganor”, sepse referuar kontratave të lidhura nga autoriteti doganor përfitues i tarifave të parkingut doganor, e përcaktuar 1,000 lekë për mjetet dhe 500 lekë për autoveturat, është *subjekti qeradhënës*, ku në total përfitimi i subjektit të sipërcituar nga Buxheti i Shtetit, vetëm nga tarifat e sipërcituara, për periudhën objekt auditimi, nga kontratat e lidhura me autoritetin doganor është rreth 8.6 milion lekë, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 432, datë 28.06.2006 të MF “Për krijimin e të ardhurave dytësore që krijojnë Institucionet Buxhetore”, si dhe shkresës nr. 13119 prot. datë 02.11.2006, të D.P.D “Mbi caktimin e tarifave të të ardhurave dytësore në Administratën Doganore”.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 86-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa të menjëhershme duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për anulimin e kontratës të lidhur nga autoriteti doganor Korçë duke nxjerrë përgjegjësitë lidhur me problematikën e konstatuar.

Menjëherë

A.2.1 Nga auditimi i të ardhurave rezulton se në 6-mujorin I të vitit 2015, të ardhurat nuk janë realizuar sipas programimit të zërave të strukturës në total 275,416 mijë lekë ose 92.7 %, ku me mosrealizim paraqiten gjithë zërat sipas strukturës. Nisur nga gjetjet dhe analiza e treguesve të të ardhurave rezulton se puna e administratës së degës doganore ka qenë në nivele më të ulëta se dy vitet paraardhëse përse i përket:

- njohjes dhe moszbatimit të legjislacionit doganor dhe të akcizës nga punonjësit e kësaj dege doganore referuar detyrave funksionale, gjë e cila ka gjeneruar efekte financiare negative me të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit;

- planifikimit të saktë dhe ndjekjes së treguesve të të ardhurave, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 9, nenit 23 dhe 24 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa për një planifikim të saktë të ardhurave sipas zërave me qëllim ngritjen në një nivel më të lartë të

realizimit të objektivave në fushën e realizimit të ardhurave, si dhe të marrë masa për kualifikimin e punonjësve lidhur me kryerjen e detyrave funksionale.

Në vijimësi

A.2.2. Nga auditimi rezulton se gjendja e borxhit në fillim të periudhës objekt auditimi është 64 debitorë, në vlerë 254,892 mijë lekë, ndërsa në fund të periudhës objekt auditimi paraqitet me 141 raste, në vlerë 440,229 mijë lekë, pra është shtuar me 77 raste, në vlerë 185,337 mijë lekë, ku masat për rikuperimin e tij referuar kërkesave të nenit 245 të Kodit Doganor; nenit 103.1/a/b, 103.2/2 dhe 103.3/5/5 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në RSH” si dhe Udhëzimit nr. 4 datë 04.08.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr. 11569/2 prot, datë 23.07.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe akcizës”, kanë rezultuar jo efektive.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 57-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masat përkatëse sipas kërkesave ligjore dhe ato në kuadrin e marrëveshjeve ekzistuese apo nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor.

Në vijimësi

A.2.3. Nga auditimi u konstatua se autoriteti doganor referuar rekomandimeve të KLSH nga auditimi i mëparshëm, të dërguara me shkresën nr. 573/16 prot. datë 20.12.2013 nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e auditit të mëparshëm, në lidhje me masat për shpërblim dëmi për 2 subjekte.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 10-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të auditit të mëparshëm të KLSH^{së}.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganës Korçë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **274,321,941 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1 Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës rezultuan vendime të marra: me minimumin e penalitetit edhe pse subjekti shkelës ka qenë përsëritës; vetëm për detyrimin doganor të lindur por pa penalitet; jo për çdo shkelje në veçanti; si dhe penalitete të marra jo në masën e duhur në përputhje me legjislacionin veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a, 256.2, 275.1, 273.2, 261.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor si dhe nenit 86.2; 85.1/a; 85.2 dhe 91.5 të ligjit 61/2012, datë 01.10.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 60-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykit,

me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 23 raste, në vlerën 243,706,790 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.01.2016

2. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe procedurave të ndjekura në deklarimin e mallrave, rezultuan raste të keqklasifikimit të artikujve; shqyrtim jo si duhet i vlerës doganore të mallrave dhe trajtim me MSABE dhe PEM me nivel të taksës doganore 0 % për artikuj që nuk plotësojnë kriteret, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2 të Kodit Doganor si dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 15-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 65 raste, në vlerën 18,936,411 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.01.2016

3. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat në zbatim të ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezultuan subjekte (Depozitues të Miratuar): të cilat nuk kanë kalibruar depozitat apo kontenierët si dhe diferencë sasive në prodhim në bazë të koeficientëve të prodhimit për të cilat autoriteti doganor ka vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 44, 45, 46, 47, 85; 89 96.1/a dhe 99 të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 78-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 17 raste, në vlerën 4,143,556 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 4 dhe 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.01.2016

4. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe shkresor në lidhje me arkiv-protokollin, rezultuan shkresa dhe procesverbale të mbajtura për shkelje në fushën doganore dhe të akcizës për të cilat Autoriteti Doganor kompetent nuk ka dalë me Vendim Administrativ veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 287.1 dhe 289.1 të Kodit Doganor si dhe nenit 98.1 dhe 99 të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 81-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 33 raste, në vlerën 3,379,682 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 6 dhe 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.01.2016

5. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar; praktikave doganore të përzgjedhura të subjekteve të cilët kanë operuar në kushtet e autorizimeve të regjimeve ekonomike rezultuan se pranë degës doganore nuk rezultojnë të dorëzuara dorëzim mostrash; dokumenti i mbylljes së regjimeve nuk është përpiluar

sipas kërkesave të legjislacionit doganor si dhe artikujve të importuar në regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm të cilëve nuk i është dhënë destinacion doganor veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.1/a, 256.2, 256.4, 261.1, 275.1, 275.2, 287.2/f, 273.1 dhe 273.2 të Kodit Doganor; kërkesat e nenit 300.2/e të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor si dhe kërkesat e nenit 11.1 të Udhëzimit 1 (nr. 12403/2 prot.), datë 06.09.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 48-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 22 raste, në vlerën 3,614,422 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.01.2016

6. Nga auditimi i dokumentacionit për shpenzimet e kryera kryera nëpërmjet bankës për marrje me qera të objektit “**Parking**” nuk është mbajtur tatimi në burim 10 % dhe 15 % për të cilin, si gjatë fazës së auditimit në terren por edhe pas saj, nuk u paraqitën fatura të cilat të vërtetojnë pagesën e kësaj vlere, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 33 “Mbajtja në burim e të ardhurave”, pika 1 gërma “ë” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar (me ligjin 156/2014 datë 27.11.2014 neni 11 ku tatimi në burim bëhet 15 %).

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 86-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën 541,080 lekë nga subjekti “[REDACTED]”.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

1. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me vlerësimin doganor rezultoi se nga agjencitë doganore, të cilat operojnë pranë Degës së Doganës Korçë, janë keqklasifikuar artikuj me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1; 261.1; 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 15-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Korçë, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, të marrë masa bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, për penalitet në masën 50,000 deri në 200,000 lekë, për **5 agjenci doganore**.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave të fillojë procedurat për të kaluar në Komisionin Disiplinor, sipas pikës 1 gërma “a” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të urdhërojë fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masës përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013, për **6 nëpunës**:

Për 5 nëpunës është propozuar masa sipas nenit 58 gërma “b-ç”, nga “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “largim nga shërbimi civil” dhe për **1 nëpunës** “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”.

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 13, 14/5, 15.3, 15.11 dhe 15.15 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

- Për problemet e konstatuara në lidhje me konceptimin e vendimeve administrative, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor dhe akcizës, me pasojë mungesë të ardhurash në Buxhetin e Shtetit, në total për 21 (njëzetë e një) raste. - Për problemet e konstatuara në lidhje me vlerësimin doganor dhe klasifikimin tarifor të artikujve jo në përputhje me nenet 33-37; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor, me pasojë shmangien e detyrimeve doganore; për problemet e konstatuara në lidhje me mbylljen e Regjimeve të Përpunimit Aktiv për veprime jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 300. 2/e të VKM^{së} nr. 205, datë 13.04.1999 në shkelje të nenit 256. 1/a; 256.2 dhe 275.1 të Kodit Doganor; mosmbajtjen e tatimit në burim, jo në përputhje me kërkesat e nenit 33 “Mbajtja në burim e të ardhurave”, pika 1 gërma “ë” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar (me ligjin 156/2014 datë 27.11.2014 neni 11 ku tatimi në burim bëhet 15 %), pasi nga D.D.K për likuidimet e kryera nëpërmjet bankës për objektin “**Parking**” nuk është mbajtur tatimi në burim 10 % dhe 15 %, të gjitha këto me dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit. (Trajtuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Shënim: Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për 6 ish-punonjës, nuk rekomandohet masë pasi rezultojnë të larguar nga sistemi doganor.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 160, datë 16.12.2015, është ngarkuar Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 17.08.2015 deri më 23.09.2015, nga audituesit shtetëror: Agron Opari, Anesti Gjika dhe Altin Dinaj, u mbikëqyr nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli, u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, z. Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naço.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Nga Dega e Doganës Korçë me shkresën nr. 741/18, datë 11.01.2016 (nr. 66, datë 06.01.2016 të Degës së Doganës Korçë) i është kthyer përgjigje KLSH ku janë marrë masa konkrete për zbatimin e plotë të rekomandimeve dhe deri tani rezulton se janë marrë 13 Vendime Administrative me vlerë **17,999.7 mijë lekë** të përcaktuara në “Masa për shpërblim dëmi” me shkresën nr. 741/15, datë 16.12.2015.

KONTROLI I LARTË I SHETIT